

KONGRESI

I AUTORITETEVE LOKALE DHE RAJONALE I KËSHILLIT TË EVROPËS



.... t'a sjellim demokracinë në
dyert tuaja, në zemër të qyteteve
dhe të rajoneve tona

The Congress



Le Congrès

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

65 vjet duke përkrahur demokracinë vendore

Konferenca e Autoriteteve Vendore, pararendësja e Kongresit, mbajti sesionin e saj të parë në Strazburg më 12 janar 1957, nën drejtimin e Jacques Chaban-Delmas (Francë). Që prej asaj kohe Kongresi është kthyer në aktor kyç në ndërtimin e një demokracie të vërtetë vendore në Evropë.

Në vitin 1975, me afirmimin në dimensionit rajonal në shtetet anëtare, objekti i Konferencës së Autoriteteve Vendore u zgjerua përtëpërfshirë edhe rajonet. Kështu, ajo u bë Konferenca e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës, duke mbledhur së bashku të gjitha komunitetet territoriale evropiane.

Teksti i themelimit

Forcimi i demokracisë vendore dhe njohja nga shtetet anëtare e rolit të saj në rritje çoi në miratimin e Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore në vitin 1985 (KEVQV).

Një faze e re pas Samitit të Vjenës

Viti 1994 shpalosi një faqe të re në çuarjen përpara të demokracisë vendore dhe rajonale me krijimin e Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës, i cili zëvendësoi "Konferencën".

"Me aq sa di unë, kjo është hera e parë në historinë e demokracive që përfaqësuesit e autoriteteve vendore janë ftuar të japin mendimin e tyre [...] me miratimin e qeverive, lidhur me kushtet e mundshme të pjesëmarrjes së tyre në krijimin e institucioneve".

Fragment nga fjalimi i Jacques Chaban-Delmans më 12 dhjetor 1957



Jacques Chaban-Delmas (Francë), Presidenti i Parë i Konferencës së Autoriteteve Vendore, 12 janar 1957

Njohja nga Krerët e Shteteve

Në Samitin e Varshavës të vitit 2005, Krerët e Shteteve të Këshillit të Evropës dhe përfaqësuesit e qeverive ritheksuan rëndësinë e demokracisë vendore dhe rajonale për të pasur një

demokraci të shëndetshme në Evropë dhe nënvizuan rolin e madh të Kongresit në realizimin e këtij misioni.

Përforcimi i instrumenteve

Kuadri i Referencës për Demokracinë Rajonale u zhvillua në vitin 2009. Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës inkurajon qeveritë e shteteve anëtare të marrin parasysht këtë tekst lidhur me politikat dhe reformat e tyre. Kongresi e ka vijuar punën e tij për promovimin e Kartës, e cila përfshin tashmë të 46 shtetet anëtare të Këshillit të Evropës.

Monitorim i demokracisë vendore

Vlerësimi i zbatimit të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore në secilin nga shtetet anëtare është baza e misionit të Kongresit.

Ky monitorim lejon angazhimin e një dialogu konstruktiv politik me autoritetet e shteteve anëtare rreth çështjeve të demokracisë vendore dhe rajonale. Kongresi ushtron rregullisht monitorime të përgjithshme nga vendi në vend; ai mund të shqyrtojë gjithashtu edhe aspekte të

veçanta të Kartës. Po ashtu, ai mund të kryejë misione faktmbledhëse urgjente për çështje të veçanta shqetësuese. Raportet, rekomandimet dhe rezolutat që miraton Kongresi u japin informacion qeverive, parlamenteve, shoqatave, përfaqësuesve të zgjedhur dhe medias rreth situatës

së demokracisë vendore dhe rajonale në vende të veçanta dhe, në veçanti, rreth zbatimit të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore. Një numër i madh reformash ligjvënëse janë vënë në lëvizje nga shtetet anëtare mbi bazën e gjetjeve të këtyre aktiviteteve monitoruese.



(Foto: Vëzhgimi i zgjedhjeve vendore dhe rajonale dhe monitorimi i Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore janë dy përparësi të rëndësishme të Kongresit)

Vëzhgimi i zgjedhjeve vendore dhe rajonale

Kongresi vëzhgon periodikisht zgjedhjet vendore dhe rajonale, veçanërisht në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës

Aktivitetet e vëzhgimit, të cilat mbulojnë si ditën e zgjedhjeve ashtu edhe fushatat zgjedhore, mundësojnë vendosjen e bashkëpunimit me përfaqësuesit e nivelit më të lartë të partive dhe të grupeve politike, komisionet zgjedhore, mediat dhe OJQ-të. Misionet për vëzhgimin e zgjedhjeve nga Kongresi kryhen në bashkëpunim me Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe

Komisionin e Venecias, veçanërisht nëpërmjet Këshillit për Zgjedhje Demokratike, por dhe me organizata të tjera ndërkombëtare të tilla si Zyra e OSBE-së për Institucionet

Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. Edhe Komiteti i Rajoneve i Bashkimit Evropian ftohet të marrë pjesë në misionet e vëzhgimit të realizuara nga Kongresi.

Postmonitorimi dhe pasvëzhgimi

Pas monitorimit dhe vëzhgimit të zgjedhjeve, Kongresi e ndjek situatën në vijim për t'u siguruar në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të tij. Për këtë qëllim ai angazhon një dialog të vazhdueshëm me shtetet anëtare.

Bashkëpunimi dhe partneriteti

Kongresi ka përforcuar bashkëpunimin dhe partneritetin me shtetet anëtare dhe me institucione dhe shoqata të tjera evropiane me synim konsolidimin e demokracisë territoriale. Aktivitetet në këtë fushë propozohen të sigurojnë më tej zbatimin e Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore dhe të rekomandimeve të Kongresit.



Kongresi organizoi pjesëmarrjen e përfaqësuesve shqiptarë në Panairin Ndërkombëtar Bashkiak NEXPO 2013 në Kroaci

Mbështetur në monitorimin e demokracisë vendore dhe rajonale si dhe në vëzhgimin e zgjedhjeve, Kongresi ofron ekspertizën e tij për shtetet anëtare dhe, nëpërmjet anëtarëve të tij, ofron një sërë përvojash praktike dhe politike, veçanërisht:

- Vlerësim të kuadrit të brendshëm ligjor dhe institucional
- Kontribut për hartimin e ligjeve dhe të politikave të reja
- Shkëmbim të praktikave të mira; shkëmbime ndërmjet kolegëve dhe seminare interaktive
- Sesione lidhëse për përfaqësuesit e zgjedhur vendor dhe rajonal

Mbështetur në situatën specifike të shteteve, si dhe në nevojat e autoriteteve vendore, mund të organizohen aktivitete në fushat vijuese: roli dhe përgjegjësitë e përfaqësuesve të zgjedhur vendor; etika në politikë dhe

vendimarrje; pjesëmarrja e qytetarëve; fushatat zgjedhore pozitive (duke u përqendruar tek zgjedhjet vendore dhe rajonale); konsultimet dhe dialogu mes autoriteteve qendrore dhe vendore; nxitja dhe shkëmbimi i përvojave në zbatimin e të drejtave të njeriut në nivel vendor; procesi i rajonalizimit; bashkëpunimi ndërkufitar.

Kontributi në planet e veprimit

Projektet e hartuara nga Kongresi janë pjesë e komponentit demokratik të Planeve të Veprimit të Këshillit të Evropës për shtetet anëtare. Bashkëpunimi projektet janë tani nën mënyrë në Armeni, Bosnje dhe Hercegovina, Gjeorgjia, Republika e Moldavisë dhe Ukraina.

Për më tepër, Kongresi është aktiv në politikën e fqinjësisë së mirë të Këshillit të Evropës që synojnë mbështetjen e reformave territoriale dhe legjislativë në

Partneriteti i ngushtë me Bashkimin Evropian

Në vitin 2005 Kongresi dhe Komiteti i Rajoneve nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi me qëllim “çuarjen përpara të demokracisë vendore dhe rajonale, decentralizimin dhe vetëqeverisjen në Evropë dhe respektimin nga autoritetet kombëtare dhe evropiane të kompetencave të përcaktuara vendore dhe rajonale”. Kjo marrëveshje u shtri më tej në vitin 2009 duke formalizuar fushat dhe metodat e bashkëpunimit ndërmjet të dy institucioneve.

vendet fqinje të tilla si Maroku dhe Tunizia.

Rrjetet dhe hub-et

Kongresi ka promovuar edhe qeverisjen e mirë dhe pjesëmarrjen e qytetarëve duke mbështetur shoqatat e autoriteteve vendore në bashkëpunim të ngushtë me rrjetet e tyre evropiane (AER, CEMR) dhe duke inkurajuar krijimin e rrjeteve, përkatësisht: Rrjetin e Shoqatave të Autoriteteve Vendore të Evropës Juglindore (NALAS), Shoqatën e Agjencive për Demokracinë Vendore (ALDA), Rrjetin Evropian të Organizatave të Trajnimit për Autoritetet Vendore dhe Rajonale (ENTO).

* Të gjitha referencat për Kosovën, qoftë për territorin, institucionet apo popullsinë, në këtë tekst do të kuptohen në pajtueshmëri të plotë me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 dhe pa paragjykim ne lidhje me statusin e Kosovës*

Një Kongres dhe dy Dhoma për 150,000 komunitete

Kongresi përbëhet nga dy dhoma: Dhoma e Autoriteteve Vendore dhe Dhoma e Rajoneve. Ai ka 306 anëtarë me të drejta të plota dhe 306 anëtarë zëvendësues, të gjithë me mandat katërvjeçar, të cilët përfaqësojnë mbi 130,000 autoritete vendore dhe rajonale në të 46 shtetet anëtare të Këshillit të Evropës.



612 përfaqësues vendor dhe rajonal të mbledhur në seancë plenare në Strazburg (Francë)

Delegacionet kombëtare në Kongres përfshijnë përfaqësues nga autoritetet vendore dhe rajonale të 46 shteteve anëtare të Këshillit të Evropës. Anëtarët ose janë të zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe kanë mandate elektorale në një autoritet vendor ose rajonal, ose janë politikisht përgjegjës para një asambleje të zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Përfaqësuesit dhe zëvendësuesit grupohen në delegacione kombëtare dhe grupe politike dhe ndahen ndërmjet dy dhomave të Kongresit, Dhoma e Autoriteteve Vendore dhe Dhoma e Rajoneve. Kongresi zgjedh presidentin e tij për dy vjet e gjysmë, me radhë, nga anëtarët e secilës prej dy dhomave. Kongresi mbledhet në Strazburg në dy seanca plenare në vit, në pranverë dhe në vjeshtë. Gjatë

këtyre seancave, Kongresi zhvillon debate tematike, shqyrton projektraporte dhe miraton rekomandime dhe rezoluta. Ai i fton përfaqësuesit e qeverive vendore dhe rajonale si dhe delegacionet nga organizata të ndryshme evropiane të marrin pjesë në to. Këto seanca ndiqen edhe nga delegatët e shteteve jo anëtare, të cilët kanë statusin e vëzhguesit.

Tre komitete për të pasqyruar përparësitë e Kongresit

Puna e Kongresit është e organizuar në tre komitete: Komiteti i Monitorimit, Komiteti i Qeverisjes dhe Komiteti për Çështjet e Aktualitetit.

Komiteti për Respektimin e Detyrimeve dhe Angazhimeve nga shtetet anëtare të Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Vendore (Komiteti i Monitorimit), përgjegjës veçanërisht për monitorimin e zbatimit të Kartës si dhe zhvillimin e rajonalizimit në Evropë, për përgatitjen e raporteve për situatën e demokracisë vendore në Evropë dhe për monitorimin e çështjeve të veçanta të lidhura me demokracinë vendore dhe rajonale në shtetet anëtare;

Komiteti i Qeverisjes, përgjegjës për çështjet që bien në fushën e mandatit statutor të Kongresit, të tilla si qeverisja, financat publike, bashkëpunimi ndërkuftar dhe ndërajonal, demokracia elektronike, si dhe pjesëmarrja e qytetarëve dhe bashkëpunimi me organet ndërqeveritare:

Komiteti i Çështjeve të Aktualitetit, përgjegjës për studimin e rolit të autoriteteve vendore dhe rajonale lidhur me sfidat më të mëdha të shoqërisë tonë dhe përgatitjen e punës për çështje tematike, të tilla si kohezioni social, arsimit, dialogu ndërkulturor, rinia, integrimi i emigrantëve, mbrojtja e fëmijëve, lufta kundër përjashtimit nga këndvështrimi i vlerave bazë të Këshillit të Evropës.

Kongresi ka krijuar dhe një **Forum Statutor**, i përbërë nga të gjithë krerët e delegacioneve kombëtare dhe 17 anëtarët e Byrosë, për të vepruar në emër të Kongresit në kohën ndërmjet sesioneve.



Çështja e pjesëmarrjes së të rinjve është një ndër përparësitë e Kongresit

Përfaqësim i drejtë

Duhet të ketë përfaqësim të drejtë për sa i përket balancën politike, gjeografike dhe gjinore në secilin delegacion. Karta e Kongresit ka përcaktuar një kufi minimal përfaqësimi prej 30% për gjininë e nënperfaqësuar për secilin delegacion.

Kongresi ka katër grupime politike:

EPP/CD – Grupi i Partive Popullore Evropiane në Kongres

SOC/G/PD – Grupi i Socialistëve, të Gjelbrit dhe Demokratët Progresiv

ILDG – Grupi i Pavarur dhe i Liberal-Demokratëve

ECR – Grupi i Konservatorëve dhe i Reformistëve Evropianë

Asambleja mbarevropiane e autoriteteve territoriale

Kongresi është organi që përfaqëson autoritetet vendore dhe rajonale të 46 shteteve anëtare të Këshillit të Evropës.

Ai përbën organin e vetëm evropian të ngarkuar me monitorimin e demokracisë vendore dhe rajonale dhe me zhvillimin e vetëqeverisjes vendore dhe rajonale në të

gjithë Evropën. Si zëri i bashkive dhe i rajoneve evropiane, Kongresi punon për të forcuar demokracinë në bazë, ndërsa inkurajon konsultimin dhe dialogun politik ndërmjet

qeverive kombëtare dhe autoriteteve vendore dhe rajonale nëpërmjet bashkëpunimit me Komitetin e Ministrave të Këshillit të Evropës.

Arritjet e Kongresit

Që prej krijimit të tij, Kongresi ka kontribuar për hartimin e një sërë traktatesh ndërkombëtare, përfshirë dhe Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore, e cila është bërë traktati ndërkombëtar bazë i referencës në këtë fushë.

Pas miratimit të Kartës nga shtetet anëtare në vitin 1985, ministrat përgjegjës për qeverisjen vendore dhe rajonale miratuan një Kuadër Reference për Demokracinë Rajonale në

vitin 2009, në Utreht (Holandë). Ky tekst shërben si korpusi i parimeve mbi të cilat mbështetet Kongresi për monitorimin e demokracisë vendore. Në kuadrin afatgjatë, Kongresi dëshiron t'a zhvillojë atë në një instrument më të detyrueshëm, i cili do të ishte instrumenti rajonal homolog i Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore.

Instrumente të tjera ligjore në fushën e demokracisë vendore dhe rajonale:

Konventa Kuadër Evropiane për Bashkëpunimin Ndërkufitar

ndërmjet Komuniteteve ose Autoriteteve Territoriale (1980)

Konventa për Pjesëmarrjen e të Huajve

në Çështjet Publike në Nivelin Vendor (1992)

Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare (1992)

Karta Evropiane Urbane dhe Karta Evropiane Urbane II;

Manifesto për një urbanizim të ri (2008)

Karta Evropiane për pjesëmarrjen e të rinjve në jetën vendore dhe rajoneve (1992) dhe Karta e Rishikuar (2003)

Konventa Evropiane e Peisazhit (2000)

Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore

Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore përcakton standardet e përbashkëta për mbrojtjen dhe zhvillimin e të drejtave dhe lirive të autoriteteve vendore dhe u kërkon shteteve që e kanë ratifikuar atë të respektojnë disa kushte, parime dhe praktika në këtë fushë. Ajo u hap për nënshkrim në vitin 1985 dhe

hyri në fuqi në vitin 1988. Karta është ratifikuar nga të 46 shtetet anëtare të Këshillit të Evropës.

Në vitin 2009 u miratua Protokoll i Shtesë për Pjesëmarrjen e Qytetarëve për të plotësuar tekstin e Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore. I hapur për nënshkrim më 16 nëntor 2009 dhe hyrë në fuqi më 1 qershor 2012, teksti ka për

qëllim t'i japë çdokujt të drejtën për të marrë pjesë në punët e autoritetit vendor brenda objektit të Kartës. Në këtë kuptim, ai reflekton Preambulën e Kartës, ku pranohet se e drejta e qytetarëve për të marrë pjesë në qeverisje është pjesë e parimeve demokratike të përbashkëta për të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës.

65 vjet demokraci vendore dhe rajonale

- 1957:** Konferenca e Parë e Autoriteteve Vendore
- 1985:** Miratimi i Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Vendore
- 1990:** Raporti i parë i vëzhgimit të zgjedhjeve
- 1993:** Krijimi i Agjencisë së Parë për Demokraci vendore
- 1994:** Konferenca e Përhershme bëhet Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës
- 1995:** Raporti i parë i monitorimit për demokracinë vendore
- 2003:** Miratimi i Kartës Evropiane të Rishikuar për Pjesëmarrjen e të Rinjve në Jetën Vendore dhe Rajonale
- 2005:** Marrëveshje Bashkëpunimi me Komitetin e Rajoneve të Bashkimit Evropian
- 2007:** Prezantimi i javës së Demokracisë Vendore Evropiane
- 2009:** Rinovimi i marrëveshjes me Komitetin e Rajoneve
- 2009:** Protokoll shtesë për të Drejtën për të Marrë Pjesë në çështjet e një Autoriteti Vendor
- 2009:** Miratimi i Referencës Kuadër të Këshillit të Evropës për Demokracinë Rajonale
- 2010 – 2012:** Reforma për strukturën e Kongresit, rregullat dhe procedurën administrative
- 2015:** Nënshkrimi i hartave të para rrugore për zbatimin e rekomandimeve të Kongresit nën dialogun pos-monitorim
- 2017:** 60 vjet promovim të demokracisë vendore dhe rajonale brenda Këshillit të Evropës

LISTA E SHTETEVE ANËTARE (dhe numri i përfaqësuesve)

Shqipëria (4)	Estonia (3)	Lituania (4)	San Marino (2)
Andorra (2)	Finlanda (5)	Luksemburgu (3)	Serbia (7)
Armenia (4)	Franca (18)	Malta (3)	Slovakia (5)
Austria (6)	Gjeorgjia (5)	Republika e Moldavisë (5)	Slovenia (3)
Azerbajxhani (6)	Gjermania (18)	Monako (2)	Spanja (12)
Belgjika (7)	Greqia (7)	Mali i Zi (3)	Suedia (6)
Bosnje-Hercegovina (5)	Hungaria (7)	Holanda (7)	Zvicra (6)
Bullgaria (6)	Islanda (3)	Norvegjia (5)	Maqedonia e Veriut (3)
Kroacia (5)	Irlanda (4)	Polonia (12)	Turqia (18)
Qipro (3)	Italia (18)	Portugalia (7)	Ukraina (12)
Republika Çeke (7)	Letonia (3)	Rumania (10)	Mbretëria e Bashkuar (18)
Danimarka (5)	Lihtenshtajni (2)		

KONTAKTE



Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës

Avenue de l'Europe – F-67075 Strasbourg Cedex - France

Tel. : +33 (0)3 88 41 21 10

congress.web@coe.int
www.coe.int/congress

